SUSTAINICUM COLLECTION
LEHRMATERIALIEN FÜR BILDUNG ZUR NACHHALTIGKEIT

# Konceptet e qendrueshmerise dimensionale- me fokus te vecante tek parimi tredimensional dhe aplikimi i tij praktik

(Resource ID: 360)

**Lisa Hauswald**
lisahausi(at)web.de
This teaching resource is allocated to following University:
**LEUPHANA - University of Lüneburg**

http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/360.Konceptet-e-qendrueshmerise-dimensionale-me-fokus-te-vecante-tek-parimi-tredimensional-dhe-aplikimi-i-tij-praktik

---

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Puna ne grup Plenium (mbledhje)** | **11 deri ne 30 studente** | **4 -7 njesi leksionesh** | **Anglisht, Shqip** |

Burimi i mesimdhenies siguron analizen e pare per qendrueshmerine dhe konceptimin e tij dimensional. Ajo fokusohe ne konceptin tredimensional te qendrueshmerise i cili sherben per nje te kuptuar me te mire te aplikuar ne shembullin e menaxhimit te mbetjeve nga nje pale e interesit lokal ne sesionin e pare. Objektivi i pare i te mesuarit eshte qe jo vetem te forcoje njohurite por edhe te inkurajoje te menduarin kritik per kete konceptim te qendrueshmerise. Brenda sesionit te dyte, studentet ne menyre interaktive perjetojne tensionet midis tre dimensioneve te qendrueshmerise nepermjet temes se vete zgjedhur dhe perpiqen

te dallojne perqasjet e zhvillimit te qendrueshem.

Ky burim mesimdhenieje paraqet qendrueshmerine me fokus ne konceptin tre dimensional. Ne kete menyre eshte nje burim baze dhe mund te zgjidhet per nje grup studentesh pa patur nevoje per njohuri paraprake persa i perket qendrueshmerise.

- Objektivi mesimor kryesor eshte te forcohen njohurite per qendrueshmerine dhe perqasjen e konceptualizimit dimensional, i cili perben konceptet kryesore te vendeve te industrializuara te Veriut. Fokusi eshte vendosur tek koncepti tre dimensional i cili perpiqet qe te strukturoje rastet e stabilitetit ne dimensionet ekologjike, sociale dhe ekonomike ndersa tregon kujdes per lidhjet e mundshme midis aspekteve te dimensioneve te ndryshme. Konceptet me me pak ose me shume dimensione permenden shkurtimisht. Objektiva te tjere per te mesuarin jane per shembull inkurajimi i studenteve per punen ne grup, negocimin dhe diskutimin, si dhe forcimin e aftesive te sistemeve te te menduarit dhe reflektuarit.

Sesioni i pare do te prezantohet duke pyetur studentet per te kuptuarin fillestar per qendrueshmerine. Ky sesion synon kryesisht te japi nje pamje te pergjithshme te arritjeve te vecanta te qendrueshmerise dhe konceptualizimin dimensional te qendrueshmerise, i cili perben njohurite baze qe nevojiten per te vijuar me tej. Ky eshte gjithashtu sesioni ku nje pale e interesit e sektorit te menaxhimit te mbetjeve do te perfshihet. Pra, nje para-diskutim midis lektorit dhe pales se interesit per konceptin tre dimensional si nje pergatitje per sesionin duhet te kihet mire parasysh. Nevojitet te ndihmohet pala e intersit te aplikoje kete koncept per shembullin e sektorit te menaxhimit te mbetjeve. Kjo eshte baza per vijueshmerine e bashkepunimit te ketij aplikimi se bashku me studentet, ne sesonin e pare. Ilustrimi permes nje shembulli nevojitet per te promovuar nje kuptim me te mire per konceptin. Kjo kerkohet per kerkimin e vete studentit per nje teme te zgjedhur ne fund te sesionit te pare.

Vendimi per menaxhimin e sektorit te mbetjeve si nje shembull i duhur eshte bazuar ne raportet " Menaxhimi i mbetjeve te bashkise ne Shqiperi " i Agjensise Europiane te Mjedisit ( 2013) dhe " Strategjise se Republikes se Kosoves per menaxhimin e mbetjeve 2012-2012" i Ministrise se Mjedisit dhe Planifikimit te Hapesires (2012). Ato tregojne se ceshtja e menaxhimit te mbetjeve eshte ende nje ceshtje e madhe ne Shqiperi dhe Kosove.

Afersisht nje jave nevojitet midis mesimit te pare dhe te dyte per te dhene kohe te mjaftueshme per kerkimin nga vete studentet ne nje dimension

specifik. Mesimi i dyte eshte gjate gjithe kohes interaktiv. Studentet do te diskutojne ne grupe te vogla aspektet e ndryshme te tre dimensioneve te temes se zgjedhur. Permes kesaj, ata mund te thellojne njohurite e tyre per konceptin e tre dimensioneve dhe te perpiqen te gjejne pikat e forta dhe te dobta. Me pas, ata do te perpiqen te gjejne nje zgjidhje per zhvillimin e qendrueshem te probleme te hasura persa i perket dimensioneve. Kjo mund te tregoje veshtiresine e gjetjes se zgjidhjes se plote te qendrueshme me synimin per permiresimin e te tre dimensioneve.

## Mjetet e mësimdhënies

Mini-projekt për studentët

## Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Nje pale interesi nga sektori i menaxhimit te mbetjeve eshte integruar ne leksionin e pare si nje partner aktiv. Ai ose ajo do te pyeten te prezantojne dhe pershkruajne situaten aktuale te menaxhimit te mbetjeve ne qytet, rajon ose ne vend. Lektori dhe pala e interesit do te takohen perpara fillimit te leksionit te pare me qellim qe te shkembehet kuptimi i konceptit te qendrueshmerise dimensionale. Me pas, pala e interesit do te jete ne gjendje te aplikoje kete koncept ne temen e menaxhimit te mbetjeve per te perpunuar me tej kete aplikim se bashku me studentet gjate sesionit.
Ai ose ajo duhet te jene te hapur te nderveprojne me studentet dhe t'u pergjigjen pyetjeve potenciale
Arsyeja e perfshirjes se pales se interesit eshte te krijoje nje reference praktike per studentet dhe te inkurajoje te mesuarin e perbashket midis lektorit/studenteve dhe pales se interesit. Te mesuarit e perbashket ne kete rast do te thote se lektori dhe studentet kerkojne njohuri per menaxhimin e mbetjeve rajonale ndersa pala e interesit mund ta shohe punen e perditshme nga nje perspektive e re e qendrueshmerise.

## Pika e forte

- Studentet do te mbledhin informacion per temen e qendrueshmerise, sfondin historik dhe konceptet dimensionale
- Studentet do te inkurajohen te reflektojne ne menyre kritike per konceptet e dhena
- Studentet do te njihen me sistemin e menaxhimit te mbetjeve dhe

problemet qe kane lidhje me te.
- Studentet do te perjetojne tensionet midis dimensioneve dhe do te perpiqen te gjejne zgjidhje te qendrueshme per nje problem te caktuar nga bota reale
- Studentet mund te kontribuojne ne permbjajtjen e leksionit
- Pala e interesit mund te perfitoje nga kjo duke marre nje pamje te re per parimin e drejtimit te qendrueshmerise dhe ( ndoshta) te rimendoje sistemin e menaxhimit te mbetjeve ( te mesuarit e perbashket)

## Pika e dobët

Jo te gjitha konceptet e qendruesherise jane permendur/ shpeguar
Perpjekje shtese nevojiten per te mos gjetur vetem nje pale te interesit te duhur i cili eshte ne gjendje dhe ka deshiren te japi nje pikture te qarte dhe korrekte te sistemit te menaxhimit te mbetjeve, por edhe ta informojme ate ne menyre qe te jete ne gjendje te aplikoje konceptin tre dimensional per temen e menaxhimit te mbetjeve dhe problemet e saj.

## Rezultatet e të mësuarit

= Ekspertiza: Studentet kuptojne, aplikojne dhe reflektojne konceptet e qendrueshmerise dimensionale te dhene.
- Metodika: Studentet jane ne gjendje te aplikojne metoden e paraqitur te punes bashkepunuese e cila perben nje perzierje te World cafe dhe lojes me role
= Sociale: studentet jane ne gjendje te diskutojne dhe negociojne ne nje menyre te orientuar drejt zgjidhjes.
- Personale: Studentet forcojne aftesine e tyre te menduarit dhe reflektimit ndaj sistemeve

## Lidhja për qëndrueshmëri

Duke qene se ky burim i mesimdhenies merret kryesisht me arritjet historike te qendrueshmerise, konceptimi i tij dimensional dhe aplikimi i tyre praktik, ka nje lidhje te larte per qendrueshmerine. Perqasjet e paraqitura te konceptualizimit ndihmojne te strukturojne tema te qendrueshmerise, te cilat jane ne pergjithesi te karakterizuara nga nje variacion i madh. Klasifikimi i aspekteve te ndryshme te temes se qendrueshmerise ne dimensione te ndryshme synon te reduktoje kompleksitetin e temes nen hetim.

## Njohuri paraprake

Asnje lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

## Përpjekjet e përgatitjes

Mesatare

## Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes

Perpjekje mesatare nevojiten per t'u pershtatur me permbajtjen dhe procedurat e leksioneve - Perpjekje e madhe/mesatare nevojitet per te gjetur nje pale interesi te pershtatshme i cili eshte ne gjendje dhe i gatshem te jape nje pamje te pegjithshme korrekte te sistemit te menaxhimit te mbetjeve dhe gjithashti ta informojme ate, ne menyre qe te jete ne gjendje te aplikoje konceptin tre dimensional te menaxhimit te mbetjeve

## Aksesi

Free

## Gjykimi / vlerësimi

Nje vleresim i mundshem mund te jete nje raport seminari me reflektimin per sesionin e dyte ne lidhje me procesin e negocimit per te gjetur zgjidhje te qendrueshme, rolin e tyre gjate World Cafe, lojes me role dhe nese koncepti tre dimensional ishte i mjaftueshem ne diskutimin e ceshtjes.
Pyetje te mundshme:
Cfare kuptuan studentet ne lidhje me Worldd Cafe/ loje me role sipas metodes ose permbajtjes?
Ishte e veshtire te arrihej konsensusi? Ishte e mundur te merreshin te gjitha dimensionet ne menyre te barabarte ne konsiderate ndersa beheshin perpjekjet per nje perqasje me zgjidhjen, synim kryesor?
Dimensionet e ndryshme ndihmuan ne strukturimin e rastit?
A jane te treja dimensionet e duhura ne kete rast? A mungon ndonje dimension? Ose a ka ndonje klasifikim me te mire? Dhe pse?
Cfare marrin ata me vete ne shtepi nga ky rast?

## Kreditim/Çertifikatë

==

## Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.